



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

|                                |   |
|--------------------------------|---|
| <b>Datë/a:</b>                 | 15.06.2021  |
| <b>Referenc-ë:</b>             | 07-353/04-106406/21                                       |
| <b>Për/ Za/ To:</b>            | Shkolla e Mesme e Mjekësisë “Rezonanca”                   |
| <b>Përmes/Preko/Through:</b>   | Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit |
| <b>Nga/ Od/ From:</b>          | Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike    |
|                                | Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit            |
| <b>Tema/ Subjekat/Subject:</b> | Pëlqim  |

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-106406/21 nga Shkolla e Mesme e Mjekësisë “Rezonanca” me të cilën kërkohet që me datë 16, 17 dhe 18 Qershor 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike, Sheshi “Skënderbeu”.

Qëllimi i aktivitetit është ofrimi i shërbimi mjekësor falas për qytetarët si: matja e tensionit, matja e sheqerit, ofrimi i dezinfektuesve si dhe ofrimi i informatave të përgjithshme dhe të nevojshme shëndetësore.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin “Skënderbeu” me datë 16, 17 dhe 18 Qershor 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.

16.06.2021

*Beyrolli*

Faqe 1 nga 1